



Datë: 23.07.2025
Numër Protokolli: 5114/2025

A.nr.851/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Ardita Haxhnikaj -Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 851/2025 të datës 07.05.2025 të parashtruar nga ankuesi D.R, kundër organit të punësimit Komuna e Shtërpçës, në çështjen juridike “Kompensim Material”, në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3, si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 23.07.2025, mori këtë

V E N D I M

I.Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr. 851/2025 e datës 07.05.2025 e parashtruar nga ankuesi D.R.

II. Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje Komisionit për Ankesa, në Komunën e Shtërpçës

A r s y e t i m

D.R. (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), ka parashtruar ankesë me datë 07.05.2025 me numër protokolli 6060/2025 të regjistruar nën shenjë A.nr.851/2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore së ankuesi është i punësuar në Komunën e Shtërpçës, në pozitën Menaxheri i Thesarit në Departamentin për Buxhet dhe Financa, në Komunën e Shtërpçës, ndërsa përtej detyrave të parapara me përshkrimin e detyrave të punës, me është kërkuar që të kryej edhe detyrat e punës përkatësisht për pozitën “Zyrtar Certifikues”, në Spitalin e Përgjithshëm në Komunën e Shtërpçës me tëj ankuesi pretendon që të behet kompensimin për mbajtjen e pozitës Zyrtar Certifikues”, në Spitalin e Përgjithshëm në Komunën e Shtërpçës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 19.05.2025, 17.06.2025, dhe 01.07.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Shtërpçës, ndërsa kjo e fundit me datë 09.07.2025 ka kthyer përgjigje në ankesë me shkresat e lëndës.

Tutje, Kryetari i Këshillit, me vendim me numër protokolli 4256/2025, të datës 20.06.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr. 851/2025, të parashtruar nga ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune, lidhur me ankesën e ankuesi D.R.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 30602025, e datës 07.5.2025, e parashtruar nga ankuesi drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesat për përgjigje në ankese drejtuar Komunës së Shtërpcës të dërguar përmes emailit; Përgjigjen në ankese me numër protokolli 851/2020, të datës 09.07.2025; Deklaratë e datës 06.12.2024, e parashtruar nga ankuesi. Emali i datës 12.12.2024, nga D.R .për I.M; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën “ Menaxheri i Thesarit”; Akt Emërimi i datës 12.01.2016, për ankuesin; Vendimi me numër protokolli 4256/2025, të datës 20.06.2025, i Këshillit;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm: Kolegji i Këshillit) pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës konstatoi se Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me kompozimin për pozitën “Zyrtar Certifikues”, në Spitalin e Përgjithshëm në Komunën e Shtërpcës, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton se ankuesi është i punësuar në Komunën e Shtërpcës dhe së i njëjti sipas Akt Emërimit të datës 12.01.2016, mbanë pozitën e punës” Menaxheri i Thesarit në Departamentin për Buxhet dhe Financa, në Komunën e Shtërpcës, ndërsa në ankesën e parashtruar në Këshill me datë 07.05.2025, ankuesi pretendon se përtej detyrave të parapara me përshkrimin e detyrave të punës, me është kërkuar që kryej edhe detyrat e punës përkatësisht në pozitën “Zyrtar Certifikues”, në Spitalin e Përgjithshëm në Komunën e Shtërpcës, duke pretenduar që ti behët kompensimin për mbajtjen e pozitës Zyrtar Certifikues”, në Spitalin e Përgjithshëm në Komunën e Shtërpcës.

Në kuptim të përcaktimit të kompetencës së Këshillit për shqyrtim dhe vendosje lidhur me këtë çështje administrative, Kolegji i Këshillit iu referua Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht nenit 5 më të cilin përcaktohet se:

Kategoritë e zyrtares/it publik janë: 1.1. Nëpunësja/i i shërbimit civil; 1.2. Nëpunësja/i i shërbimit publik; 1.3. Krijuesja/i dhe performuesja/i e/i artit dhe kulturës; 1.4. Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës; dhe 1.5. Zyrtarja/i i kabinetit. 2. Nëpunësja/i i shërbimit civil është zyrtarja/i publik në kuadër të shërbimit civil i cili merr pjesë në formulimin dhe/apo zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme profesionale dhe administrative në zbatim. Nëpunësja/i i shërbimit civil ushtron detyrën në pozitën përkatëse, duke filluar nga zyrtarja/i profesional deri në pozitën e drejtueses/it të lartë, në administratën e Presidentes/it të Republikës së Kosovës, në administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në Zyrën e Kryeministres/it të Republikës së Kosovës, në Ministri, në Agjenci Ekzekutive dhe në degë lokale të tyre, institucione të pavarura kushtetuese, në agjenci të pavarura dhe rregullatore, në administratën komunale dhe çdo nëpunës/ës statusi i të cilit është përcaktuar si nëpunës/ës i shërbimit civil, me ligj të veçantë. 3. Nëpunësja/i i shërbimit publik është zyrtarja/i publik i cili ofron shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit, në fushën e mjekësisë ligjore, si dhe shërbime tjera të ngjashme publike. Nëpunësja/i i shërbimit publik ushtron detyrën në pozitën përkatëse duke filluar nga niveli profesional deri në nivelin e lartë drejtues. Nëpunësja/i i shërbimit publik është edhe nëpunësja/i i shërbimeve të

brendshme në administratën e shërbimeve publike pjesë e administratës shtetërore, në administratën e shërbimeve publike apo pjesë e komunës...”, dhe se nga ky konstatim rrjedhë së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr. 851/2025 të datës 07.05.2025 të parashtruar nga ankuesi, vetëm sa i përket pretendimeve lidhur kompensimin për mbajtjen e pozitës “Zyrtar Certifikues”, në Spitalin e Përgjithshëm në Komunën e Shtërpçës.

Pas konstatimit si më lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.851/2025 të datës 07.05.2025, dhe meqenëse nga shkresat e lëndës nuk vërehet se pala ankuese ka shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative pranë organit punëdhënës, Kolegji duke u bazuar në nenin 88 të Ligjit Nr.08/L-196 për Zyrtarët Publikë, nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, vendosi që të shpallë veten jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr. 851/2025 të datës 07.05.2025 dhe të bartë lëndën të organi kompetent, në këtë rast Komisioni i Ankesave në Komunën e Shtërpçës.

Prandaj bazuar në konstatimet si më lartë Kolegji i Këshillit, lidhur me ankesën e ankuesit vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi vetëm sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me kompensimin për mbajtjen e pozitës “Zyrtar Certifikues”, në Spitalin e Përgjithshëm në Komunën e Shtërpçës.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.851/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit D.R;
- Komisionit të Ankesave në Komunën e Shtërpçës;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve, në Komunën e Shtërpçës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.